

V E N D I M
Nr.28, datë 3.7.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Manol Konomi,	Anëtari
Feti Gjilani,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtar i“““
Franc Jakova,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 30.4.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.14 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : BASHKIA VLORË, e përfaqësuar nga kryetari, Elham Sharra.

SUBJEKT I INTERESUAR : SEKRETARIATI I SHTETIT PËR PUSHTETIN LOKAL TIRANË, në mungesë.

K U N D Ë R : PREFEKTURES VLORE, e përfaqësuar nga Lavdosh Hysomema, Albert Pashaj e Alketa Elezi.

O B J E K T I :

Shpallja antikushtetues dhe në kundërshtim me Ligjin nr.7608, datë 2.9.1992 “Për Prefekturat” si dhe me Ligjin nr.7652, datë 3.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, i disa vendimeve të prefektit për pezullimin e shpalljes dhe të zbatimit të vendimeve të Këshillit të Bashkisë dhe të kryetarit.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

1. Nga shqyrtimi i çështjes del e qartë se ka dy pikëpamje të kundërta në lidhje me kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 6 të Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 “Për Prefekturat”.

Përmbajtja e nenit 6 të këtij ligji është :

“Organet e pushtetit lokal janë të detyruara të njoftojnë prefektin për aktet e nxjerra prej tyre brenda 10 ditëve nga dita e miratimit të tyre.

Prefekti duhet të shprehet për ligjshmërinë e aktit brenda 10 ditëve nga dita e marrjes.

Kur prefekti vëren që një akt i nxjerrë nga organet e pushtetit lokal është i paligjshëm, ka të drejtë ta dërgojë atë në gjykatë. Në këtë rast pezullohet zbatimi i aktit”.

Kryetari i Bashkisë së Vlorës mbron tezën se vendimet e Këshillit të Bashkisë dhe të kryetarit shpallen dhe zbatohen menjëherë pas marrjes së tyre, pa pritur kalimin e afatit 10 ditor që parashikohet nga paragrafi i dytë i nenit 6 dhe para se prefekti të jetë shprehur për ligjshmërinë e këtyre akteve.

Titullari i prefekturës, nga ana e tij, duke i bërë një interpretim të ndryshëm përmbajtjes të këtij paragrafi dhe duke u mbështetur në pikën “2, 3” të rregullores “Për kompetencat dhe detyrat e administratës të Bashkisë e Komunës”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.441, datë 15.8.1994, pretendon se ka të drejtë të pezullojë vetë ose të kërkojë nga Kryetari i Bashkisë ose i Komunës, që të pezullojnë shpalljen dhe zbatimin e akteve të marra prej tyre ose prej këshillave respektive.

Gjykata Kushtetuese, pasi i bëri një analizë të hollësishme normës të nenit 6 të Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 “Për Prefekturat”, arriti në konkluzion se të dy këto pikëpamje dhe pjesa e rregullores “Për kompetencat dhe detyrat e administratës të Bashkisë e Komunës”, pika “2, 3” të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.441, datë 15.8.1994, ku thuhet se : “Kryetari është i detyruar të pezullojë zbatimin e akteve të tij apo të këshillit kur një gjë e tillë kërkohet zyrtarisht nga prefekti”, nuk pajtohen aspak me frymën dhe qëllimin e përmbajtjes të kësaj dispozite.

Organet e pushtetit lokal, sipas kësaj dispozite, detyrohen brenda 10 ditëve të njoftojnë prefektin për aktet e nxjerra prej tyre, kusht ky i domosdoshëm për realizimin e së drejtës dhe detyrës,

që i ngarkohet me ligj prefektit, për të kontrolluar dhe shprehur mbi ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal.

Gjithashtu, me ligj caktohet një afat prej 10 ditësh, brenda të cilit prefekti detyrohet të kontrollojë ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal dhe të njoftojë ato mbi përfundimin e kontrollit. Kuptohet se përpara kalimit të afatit të sipërm, këto akte nuk mund të vihen në zbatim, sepse e drejta ligjore e prefektit do të merrte një karakter krejt formal dhe, për pasojë, qëllimi i ligjit nuk do të arrihej, ndalimi në kohë dhe me efekt i një vendimi eventualisht të kundërligjshëm.

Gjykata e gjen të nevojshme të vërë gjithashtu në dukje se prefekti nuk ka të drejtë të vendosë vetë dhe as të detyrojë kryetarin e Bashkisë ose të Komunës që të pezullojnë aktet e tyre. Prefekti ka vetëm të drejtën, kur konstaton se një akt nuk pajtohet me ligjin dhe organi që e ka nxjerrë këtë akt ngulmon në pikëpamjen e vet, t'i drejtohet, gjithnjë brenda afatit 10 ditor, Gjykatës kompetente. Zbatimi i aktit në këtë rast, pezullohet gjer në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

2. Gjatë diskutimit të çështjes u ngritën dhe u mbrojtën dy probleme me rëndësi parimore e juridike, të cilat Gjykata e quajti të udhës t'i shtrojë për shqyrtim dhe të shprehet në vendimin e saj.

a. Ligji nr.7608, datë 22.9.1992 "Për Prefekturat", i cili parashikon të drejtën e prefektit për të mbikqyrur ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal, vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat kushtetuese, me nenin 3 të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 "Për disa shtesa në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në bazë të Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për Prefekturat" neni i parë, prefekti ka të drejtën dhe detyrën të kontrollojë ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal dhe pikërisht, ky është qëllimi kryesor i krijimit të prefekturave. Kjo e drejtë e prefektit shprehet në mënyrë të përsëritur në këtë ligj dhe konkretisht në nenin 4 paragrafi i parë e 5 pika 2.

Gjykata, përpara se të bëjë analizën e përmbajtjes të Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 "Për Prefekturat" në lidhje me nenin 3 të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 e quan të nevojshme të japë përmbajtjen e plotë të nenit 3 të lartpërmendur.

"Organizimi dhe funksionimi i pushtetit lokal bëhet në bazë të parimeve të vetëqeverisjes, të pavarësisë, të autonomisë dhe decentralizmit.

Organet e pushtetit lokal në veprimtarinë që kryejnë mbështeten në dispozitat kushtetuese, ligjet dhe aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Parimet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit lokal nuk mund të cenojnë karakterin unik kombëtar të shtetit shqiptar.

Kompetencat e organeve të pushtetit lokal caktohen me ligj".

Siç shihet, neni 3 i Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992, i cili konsakron parimet e vetëqeverisjes, të pavarësisë, të autonomisë dhe të decentralizmit, përcakton njëkohësisht, në mënyrë precize, në paragraf II, III e IV dimensionin e këtyre parimeve, duke caktuar kriteret. Këto kriterë konstitucionale janë : Caktimi i kompetencave të organeve të pushtetit lokal bëhet me ligj; b) moscënim i karakterit unik kombëtar i shtetit dhe c) përputhja me kushtetutën, me ligjet dhe me aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre, i veprimtarisë së organeve të pushtetit lokal dhe i vendimeve të tyre.

Mbikqyrja për zbatimin dhe respektimin e ligjshmërisë, në radhë të parë, është detyrë e organit ekzekutiv, si organ qeverisës. Me Ligjin nr.7608, datë 22.9.1992 "Për Prefekturat", i cili i përgjigjet kërkesës së paragrafit të dytë të nenit 3 të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992, e drejta e kontrollit për ligjshmërinë e akteve që nxjerrin organet e pushtetit lokal, ka kaluar në kompetencën e prefekteve me cilësinë e tyre si përfaqësues të qeverisë në planin lokal.

Në kushtet ligjore të parashtruara më lart, Gjykata Kushtetuese është e mendimit se Ligji Nr.7608, datë 22.9.1992 dhe konkretisht normat e neneve 1, 4 paragrafi i dytë e 5 pika 2 të këtij ligji nuk vijnë aspak në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 3 të Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992.

b. Përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 6 të ligjit për prefekturat ka karakter antiligjor. Sipas kësaj pikëpamje njohja prefektit të drejtën që të shprehet për ligjshmërinë e akteve të organeve të pushtetit lokal prek parimin e pavarësisë së këtyre organeve në marrëdhëniet e tyre me prefektin, parim ky i shprehur qartë në nenin 4, paragrafi i fundit.

Pikëpamja e sipërme mbështetet në një interpretim të gabuar të ligjit, frymës dhe qëllimit të tij. Është e qartë se kontrolli që ushtron prefekti mbi aktet e organeve të pushtetit lokal, nuk i ve këto organe në marrëdhënie varësie ndaj prefektit, për të vetmen arsye sepse, në analizë të fundit, është gjykata ajo që vendos mbi ligjshmërinë ose jo të aktit në kontestim.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 5 dhe nenit 25 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

1. Rrëzimin e kërkesës së Bashkisë Vlorë.
 2. Shfuqizimin e pikës “2,3” të Rregullores “Për kompetencat dhe detyrat e administratës të Bashkisë e Komunës” miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.441, datë 15.8.1994 në pjesën që shprehet se : “Kryetari është i detyruar të pezullojë zbatimin e akteve të tij apo të këshillit kur një gjë e tillë kërkohet zyrtarisht nga prefekti”.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi me shpalljen e tij në Fletoren Zyrtare.
U shpall sot, më 3.7.1996

MENDIMI I PAKICES

Jam kundër vendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

Kërkesa e Kryetarit të Bashkisë së Vlorës është e drejtë.

Prefekti i Vlorës duke keqinterpretuar Ligjin nr.7608, datë 22.9.1992 “Për Prefekturat” me aktet e tij ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 3 të Ligjit Kushtetues “Për disa plotësime e ndryshime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit organet lokale të pushtetit janë të organizuara dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve të vetëqeverisjes, të pavarësisë, të autonomisë lokale dhe të decentralizimit, të cilat kanë gjetur zbërthimin e tyre të mëtejshëm në Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit lokal”, veçanërisht me përmbajtjen e nenit 4 paragrafi i dytë i Ligjit “Për Prefekturat”, në të cilin thuhet shprehimisht se ndërmjet prefektit dhe organeve lokale të pushtetit nuk ka marrëdhënie vartësie.

Për vërtetimin e saj, kryetari i Bashkisë ka paraqitur një numër shkresash të Prefektit të Vlorës, drejtuar Bashkisë së Vlorës, në të cilat prefekti shprehet veç e veç për ligjshmërinë e secilit vendim, duke urdhëruar Bashkinë e Vlorës të bëjë shpalljen dhe zbatimin e tyre si dhe shkresën nr.57, datë 24.11.1995, në të cilën i hiqet vërejtja Bashkisë Vlorë, duke theksuar midis të tjerave se : “Të gjitha vendimet e pamiratuara nga prefekti nuk duhet të shpallen dhe të zbatohen nga ana e juaj”.

Prefekti, duke qenë përfaqësues i Qeverisë në planin lokal, nuk ka të drejtë t’i japë urdhëra organeve lokale të pushtetit e as të ndërhyjë në punë e tyre, sepse sipas nenit 22 të Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e organeve lokale të pushtetit” vendimet e tyre zbatohen menjëherë pas shpalljes, pa patur aspak nevojë që ato më parë të jenë miratuar nga ndonjë organ tjetër shtetëror.

Ligji i ka dhënë të drejtën Prefektit që kur vëren se një akt i miratuar nga organet lokale të pushtetit vjen në kundërshtim me ligjet e shtetit ta dërgojë çështjen për shqyrtim në gjykatën kompetente, e cila e zgjidh atë në mënyrë përfundimtare. Në këto raste zbatimi i atij akti pezullohet vetvetiu.

Në këto rrethana, kërkesa e kryetarit të Bashkisë Vlorë, nuk duhej rrëzuar si e pabazuar.

ANËTARI
Veli Budo